

**20060130180**

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR GARANCINË E REPUBLIKËS**  
**SË MAQEDONISË SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN CHE**  
**“KOZJAK” ME BANKËN KINEZE DHE FIRMËN CWE (CHINA INTERNATIONAL**  
**WATER&ELECTRIC CORP.)**

Neni 1

Në Ligjin për garancinë e Republikës së Maqedonisë sipas marrëveshjes për hua për projektin CHE “Kozjak” me Bankën kineze dhe firmën CWE (China International Water & Electric Corp.), (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/98, 70/2001 dhe 98/2002”), në nenet 1 dhe 3 fjalët: “Elektroekonimia e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Elektranat e Maqedonisë”.

Neni 2

Në nenin 4 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

“Për një pjesë të mjeteve të huas nga Banka e Kinës për Projektin CHE ”Kozjak”, të cilat do të shfrytëzohen nga ana e ShA EEM dhe ShA EPMSO, Shoqëria Aksionare “Elektranat e Maqedonisë” në pronë shtetërore – Shkup, do të lidhë marrëveshje të veçanta me ShA EEM dhe ShA EPMSO për shfrytëzimin dhe kthimin e mjeteve të shfrytëzuara për investime, të cilat me transformimin e ShA EEM janë në kompetencë të tyre.”

Neni 3

Neni 5 ndryshon si vijon:

“Ministria e Financave dhe Shoqëria Aksionare “Elektranat e Maqedonisë” në pronësi shtetërore, do të lidhin marrëveshje me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella mbi bazë të garancisë së dhënë Bankës së Kinës nga neni 1 i këtij ligji.

Në qoftë se obligimet e arritura në bazë të kamatës dhe kryegjësë, brenda afateve të përcaktuara me marrëveshjen për hua, në emër të Shoqërisë Aksionare “Elektranat e Maqedonisë” në pronësi shtetërore, i paguan Republika e Maqedonisë, ministri i Financave mund të lëshojë urdhëresë te Drejtoria e të Hyrave Publike për bllokimin e mjeteve të Shoqërisë Aksionare “Elektranat e Maqedonisë” në pronësi shtetërore, mbi bazë të kthimit të TVSh-së, me qëllim që të përmbushen obligimet e arritura ndaj kreditorit, përkatësisht shtetit t’i kompensohen mjete në denarë në lartësinë e pagesës së kryer, të rritur për kamatën e përlllogaritur dhe shpenzimet e krijuara në lidhje me transaksionin përkatës.”

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.